



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISE

MARS 2022

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Mars 2022

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2022
Drejtoria e Analizave Makroekonomike dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: Juli.Lubonja@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE _____ **2**

ZHVILLIMET EKONOMIKE _____ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit _____ 3
2. Kursi mesatar i Këmbimit _____ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave _____ 5
4. Bilanci i Pagesave _____ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar _____ 7
6. Kredia për Ekonominë _____ 8
7. Oferta e Parasë _____ 9
8. Depozitat sipas burimeve _____ 10

SEKTORI FISKAL _____ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar _____ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve _____ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal _____ 13

ANEKSI STATISTIKOR _____ **13**

Veçoritë Kryesore


- Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Mars 2022, arriti në 108.9;
- Norma vjetore e inflacionit për muajin Mars 2022 ishte 5.7 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Mars 2022 ishte 111.58 lekë për dollarë dhe 122.96 lekë për euro;
- Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Mars 2022 shënuan kuotën 0.46 përqind për ato 12-mujore; 0.30 përqind për depozitat 6-mujore; 0.16 përqind për depozitat 3-mujore dhe 0.48 përqind për depozitat 1-mujore;
- Normat e interesit për huatë në lekë ishin 6.01 përqind për huatë 12-mujore dhe 6.55 përqind për ato 6-mujore;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.593.204 milionë lekë në muajin Mars, duke shënuar një rritje prej rreth 8.4 përqind, krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e katërt të 2021 rezultoi me rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 726.6 milionë euro.
- Situata Buxhetore për periudhën Mars 2022 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 21.88 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një suficit prej 13.01 miliardë lekë.
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Mars 2022, arritën në rreth 139.41 miliardë lekë ose afërsisht 4.5% më shumë se plani për këtë periudhë.
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 117.52 miliardë lekë ose rreth 2.3% më pak se shpenzimet e planifikuara për këtë periudhë.

Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Mars 2022 ishte 5.7%, një vit më parë ky ndryshim ishte 1.2%. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Mars 2022, krahasuar me Shkurt 2022 është 2.4%. Një muaj më parë, Shkurt 2022, IÇK shënoi rritje mujore gjithashtu prej 1.3%.

Referuar një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Mars 2021 shënoi rritje mujore prej 0.7%, në krahasim me muajin paraardhës.



Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- “Ushqime dhe pije joalkolike” me rritje vjetore të çmimit prej +9.3%, duke kontribuar me +9.3 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +5.7%.
- “Transport” me rritje vjetore të çmimit prej +19.9%, duke kontribuar me +1.08 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +5.7%.
- “Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me rritje vjetore të çmimit prej +2.3%, duke kontribuar me +0.44 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +5.7%.

- “Pije alkolike dhe duhan” me rritje vjetore të çmimit prej +4.9%, duke kontribuar me +0.25 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +5.7%.
- “Hotele, kafene dhe restorante” ka pësuar rritje vjetore të çmimit prej +4.5%, duke kontribuar me +0.21 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +5.7%.
- “Argëtim dhe kulturë”, me rritje vjetore +3.5%, duke kontribuar me +0.12 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +5.7%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2021	0.4	1.1	1.2	1.9	1.8	1.6	2.2	2.4	2.5	2.4	3.1	3.7
2022	3.7	3.9	5.7									

Burimi: INSTAT


2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Mars 2022, arriti në 122.96 lekë/euro, duke shënuar rritje në vlerë me 1.35 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Mars, një euro u këmbye me 121.62 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Mars 2022 arriti në 111.58 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 4.26 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit Mars, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 109.28 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Mars të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 0.31 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është nënçmuar në masën 7.69 përqind. Në përgjithësi, forcimi i lekut në vitet e fundit ka ardhur si pasojë e konjunkturave të jashtëme, për shkak të krizave të njëpasnjëshme, nga pandemia botërore Covid-19 deri tek lufta në Ukrainë.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një nivel mesatar rreth 0.91 dollarë/euro për muajin Mars 2022.



Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë kësaj periudhe përmendim: qendrueshmëria e kursit të këmbimit për shkak të ndërhyrjes së shpejtë të BSH-së, stabiliteti i situatës makroekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasiteti në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarrja nga BSH-ja, etj.



3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Mars 2022, normat e interesit të depozitave me afat 12 dhe 1 mujore shënuan vlerat më të larta prej 0.46 dhe 0.48 përqind përkatësisht, pasuar nga ato me afat 6 dhe 3 mujore që arritën kuotën 0.30 dhe 0.16 përqind përkatësisht.

Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 6, 3 dhe 1 mujore kanë shënuar rritje mujore prej 0.03, 0.03 dhe 0.1 pikë përqindje përkatësisht. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 12 mujore nuk patën ndryshim.

Referuar një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12 dhe 1 mujore kanë shënuar rritje vjetore përkatësisht prej 0.01 dhe 0.08 pikë përqindje. Ndërsa ato 6 mujore shënuan rënie me 0.04 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 mujore, gjatë muajit Mars 2022, arritën përkatësisht kuotën prej 6.55 dhe 6.01 përqind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 6 dhe 12 mujore kanë shënuar rënie me 0.23 dhe 0.39 pikë përqindje përkatësisht. Krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 dhe 12 mujore kanë shënuar rritje vjetore me 0.71 dhe 0.66 pikë përqindje.



Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore për muajin Mars 2022 patën rënie vjetore me 0.26 pikë përqindje.

4. Bilanci i Pagesave



Përgjatë vitit 2021, Bilanci i Pagesave u zgjerua, duke shënuar vlerën 936 milion euro, nga 655 milion euro që ishte një vit më parë (2020). Gjithashtu, vetëm për tremujorin e katërt të 2021, BP shënoi vlerën 727 milion euro, krahasuar me tremujorin e katërt të 2020 që shënoi vlerën -143 milion euro.

Përgjatë vitit 2021, defiçiti i llogarisë korente pati një zgjerim të lehtë në -1,186 miliardë euro krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë që ishte -1,153 miliardë euro. Po ashtu, vetëm për tremujorin e katërt të 2021, llogaria korente e zgjeroi defiçitin në -546 milion euro, krahasuar me tremujorin e katërt të 2020 që ishte -349 milion euro.

Përgjatë vitit 2021, Llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në vlerën +1,913 miliardë euro krahasuar me +1,648 miliardë euro në vitin 2020. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e katërt të 2021, llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në +1,180 miliardë euro, krahasuar me +105 mln euro në tremujorin e katërt të 2020.


Përgjatë vitit 2021, Investimet e huaja direkte shënuan vlerën +1,057 miliardë euro ose +8.0%, krahasuar me +979 milion euro në vitin 2020. Ndërsa, vetëm për tremujorin e katërt të 2021, IHD regjistruan vlerën +302 mln euro ose +21.7%, krahasuar me +248 mln euro në tremujorin e katërt të 2020.

Përgjatë vitit 2021, të hyrat nga shërbimet të lidhura përgjithësisht me Turizmin u zgjeruan në vlerën +1,912 miliardë euro, (ose rreth 1.9 herë më shumë), krahasuar me +988 milion euro në vitin 2020.




5. Mjetet Valutare Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Mars 2022, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 98.302 milionë lekë krahasuar me muajin Mars të vitit 2021. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës Qëndrore me 77.898 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rënie me 12 451 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rënia mujore prej 11.733 milionë lekë e Bankës Qëndrore.



Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,593.204 milionë lekë në muajin Mars 2022, duke shënuar një rritje prej rreth 123.956 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 8.4 përqind.

Në muajin Mars 2022, sistemi bankar rezulton me rritje mujore prej 908 milionë lekë, ose me 0.1 përqind më pak në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.





6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Mars 2022 arriti në rreth 683.324 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 72.525 milionë lekë, ose rritje me rreth 11.9 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (51.6%) dhe monedhave të huaja (48.4%).

Gjatë muajit Mars 2022, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 59 përqind ose 403.166 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 35.39 përqind ose rreth 241.807 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 3.59 dhe 2 përqind apo 24.510 dhe 13.642 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin mars 2022, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 69.69 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 24.12 përqind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 1.93 dhe 4.27 përqind secili.



7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 365.999 milionë lekë në fund të muajit Mars 2022. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Mars 2022 ka shënuar rritje mujore prej 0.16 përqind dhe rënie vjetore prej 0.69 përqind, duke arritur nivelin 22.97 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rritje mujore prej 0.14 përqind, dhe rënie vjetore prej 1.12 përqind, duke shënuar nivelin 29.9 përqind.


Fig-11



Raportet e parasë jashtë bankave me M3 & Depozitat
Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Mars 2022, kanë shënuar rritje vjetore prej 81.066 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 76.1 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Mars 2022 shënuan rritje prej 21.993 milionë lekë në krahasim me muajin mars 2021. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 79.9 përqind të depozitave në lekë.

Fig-12




Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Mars 2022, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 79.9 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 14.9 përqind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 3.2 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 76.1 përqind dhe rreth 20.8 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 77.8 përqind e totalit.

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 954,367 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (223.628 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (23.632 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (24.181 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.370 milionë lekë) në totalin e depozitave. Gjatë muajit Mars 2022, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1.227.178 milionë lekë.

Fig-14



Përberja e depozitave Mars '22


Burimi: Banka e Shqipërisë

Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 3.217 milionë lekë. Ndërsa, krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 103.059 milionë lekë.

Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Mars 2022 janë mbledhur rreth 139.408 miliardë lekë të ardhura, përkundrajt shpenzimeve të përgjithshme prej 117.523 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 104.161 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 45.532 miliardë lekë në shpenzime për fonde speciale.



Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 95.732 miliardë lekë. Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 7.753 miliardë lekë (ose 1.8% më pak se me planin e periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 29.033 miliardë lekë (ose rreth 0.4% më pak se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 5.108 miliardë lekë (ose rreth 1.9% më pak se plani për periudhën Mars 2022).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 104.161 miliardë lekë, 20.333 miliardë lekë (19.52% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 11.029 miliardë lekë (10.59%) për shpenzime interesi, 9.920 miliardë leke (9.52%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 252 miliardë lekë (0.24%) për subvencione, 45.532 miliardë lekë (43.71%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 11.130 miliardë lekë (10.69%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 5.964 miliardë lekë (5.73%) për shpenzimet tjera.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Mars 2022 ishin rreth 139.408 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 132.519 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 5.108 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Janar - Mars 2022 (mld Lekë) Revenues during January - March 2022 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	Mars '22 Mar '22	Mars '21 Mar '21	Ndrysh(%) Chang (%)
	TVSH (VAT)	45.639	31.730	+43.8
	Taksa doganore (Custom Tax)	1,728	1,506	+14.7
	Akcizat (Excise)	11.367	10.346	+9.9
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	14.277	10.579	+35
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	10.569	9.304	+13.6
	Taksat nacionale (National Tax)	12.152	9.312	+30.5

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Statistikat Fiskale: Mars - 2022

Source: Ministry of Finance and Economy, Fiscal Statistics: March - 2022

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 21.855 miliardë lekë gjatë periudhës Mars 2022, u përdor kryesisht për financim të brendshëm.

Për periudhën Janar-Mars 2022, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 139.408 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 117.523 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për periudhën Janar - Mars 2022, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 132.519 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 104.161 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 45.532 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1 **Indeksi i çmimeve të konsumit**
Consumer price index (in %)

Muaji	Mujor (Monthly)							Mesatar Mujor (Monthly Average)							Vjetor (Annual)							Month
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	
Janar	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.3	1.3	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.3	1.3	1.5	2.8	1.7	1.9	1.5	0.4	3.7	January
Shkurt	1.1	0.5	0.8	0.6	0.4	1.1	1.3	1.0	1.0	1.1	1.1	1.1	1.2	1.3	0.2	2.2	2.1	1.7	1.2	1.1	3.9	February
Mars	0.5	0.4	0.3	-0.3	0.6	0.7	2.4	0.8	0.8	0.9	0.6	0.9	1.0	1.7	0.3	2.1	2.0	1.1	2.1	1.2	5.7	March
Prill	-0.4	-0.6	-0.5	-0.2	-0.4	0.2		0.5	0.5	0.5	0.4	0.6	0.8		0.3	1.9	2.1	1.4	1.9	1.9		April
Maj	-1.2	-1.2	-1.2	-1.0	-0.8	-0.9		0.2	0.1	0.2	0.1	0.3	0.5		0.7	2.0	2.1	1.5	2.1	1.8		May
Qershor	-0.6	-0.4	-0.1	-0.3	-0.6	-0.8		0.04	0.0	0.1	0.1	0.2	0.3		1.2	2.2	2.4	1.3	1.8	1.6		June
Korrik	0.0	-0.1	-0.3	-0.1	-0.5	0.1		0.04	0.0	0.1	0.0	0.1	0.2		1.9	2.0	2.3	1.5	1.4	2.2		July
Gusht	0.9	0.4	0.4	0.3	0.2	0.4		0.14	0.1	0.1	0.1	0.1	0.3		2.0	1.6	2.2	1.5	1.3	2.4		August
Shtator	0.4	0.4	0.2	0.1	0.4	0.5		0.17	0.1	0.1	0.1	0.1	0.3		1.8	1.6	2.1	1.3	1.5	2.5		September
Tetor	-0.2	0.0	-0.2	-0.2	0.2	0.1		0.04	-0.1	-0.1	-0.1	0.1	0.3		1.8	1.6	2.1	1.3	2.0	2.4		October
Nëntor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2	-0.5	0.2		0.12	0.1	0.1	0.0	0.1	0.3		1.9	1.7	1.8	1.4	1.6	3.1		November
Dhjetor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2	0.3	0.8		0.05	-0.1	-0.1	-0.1	0.1	0.3		1.9	1.7	1.8	1.4	1.1	3.7		December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2

Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2022	2022	Currency
								Janar January	Shkurt February	Mars March	
Mesatarja e periudhës											Average of period
USD	125.96	124.15	119.10	107.99	109.85	108.65	103.68	107.32	107.02	111.58	USD
EURO	139.74	137.36	134.15	127.59	123.01	123.77	122.37	121.49	121.32	122.96	EURO
Fundi i periudhës											In the end of period
USD	125.79	128.17	111.10	107.82	108.64	100.84	106.54	108.18	108.52	109.28	USD
EURO	137.28	135.23	132.95	123.42	121.77	123.70	120.76	120.90	121.32	121.62	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2018	2019	2020	2021	2022 Janar January	2022 Shkurt February	2022 Mars March	In percent
Norma e depozitave								Deposits rates
12-M	0.73	0.49	0.41	0.47	0.44	0.46	0.46	12-M
6-M	0.59	0.42	0.35	0.35	0.35	0.27	0.30	6-M
3-M	0.28	0.23	0.21	0.15	0.15	0.13	0.16	3-M
1-M	0.76	0.66	0.49	0.41	0.39	0.38	0.48	1-M
Norma e huasë								Lending rates
12-M	5.66	6.25	6.05	5.91	6.56	6.40	6.01	12-M
6-M	8.12	7.07	6.28	6.16	5.82	6.78	6.55	6-M
Norma e letrave me vlerë								Securities rates
Bono thesari 1/								Treasury bills 1/
3-M	-	-	-		0.96	0.85	1.00	3-M
6-M	-	-	-			1.21	1.24	6-M
12-M	1.43	1.69	1.77	1.60	1.58	1.58	1.87	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2022

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2022

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	45,726	87,679	139,408	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	189	1,000	1,782	Grands
II.	Të ardhura tatimore	44,054	83,482	132,519	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	30,038	57,882	95,732	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	15,075	29,586	45,639	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,652	3,992	14,277	Profit Tax
3	Akcizat	3,495	7,463	11,367	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	4,028	7,099	10,569	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	5,324	8,714	12,152	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	464	1,029	1,728	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	3,166	5,790	7,753	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	277	557	1,065	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	9	15	25	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	2,880	5,218	6,664	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	10,850	19,811	29,033	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	9,312	17,055	25,008	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,500	2,651	3,831	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	38	105	194	Compensation income in the value of owners
III.	Të ardhura Jotatimore	1,484	3,197	5,108	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0	0	0	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	942	2,058	3,325	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	188	354	555	Utility fees
4	Të tjera	354	785	1,227	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	32,599	68,920	117,523	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	31,895	67,325	104,161	Current Expenditures
I.1	Personeli	6,740	13,486	20,333	Personnel expenditures
1	Paga	5,781	11,564	17,428	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	952	1,906	2,859	Social insurance contributions
3	Arsimi i larte nga te ardhurat e veta	6	17	46	Higher education from its own income
I.2	Interesat	5,037	7,446	11,029	Interest
1	Të Brendshme	4,010	5,907	8,947	Domestic
2	Të Huaja	1,027	1,539	2,082	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	1,732	5,776	9,920	Operational & Maintenance
I.4	Subveconet	74	167	252	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	14,449	30,212	45,532	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	10,645	21,559	33,340	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	3,129	7,979	11,515	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve	674	674	677	Owners' Compensation Fund
I.6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	2,457	6,764	11,130	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,407	3,473	5,964	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	45	109	175	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,162	2,891	5,017	Economic Aid
3	Bonusi i lindjeve	200	400	700	Birth bonus
I.8	Transferime Kapitale	0	0	0	Capital transfers
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca	0	0	0	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	703	1,596	7,986	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	0	175	2,653	Domestically financing
2	Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte	1	26	97	From higher education system's own revenues
3	Financimi Huaj	703	1,395	4,043	Foreign financed
IV	Fondi i rindertimit	0	0	1,193	Reconstruction fund
V.	DEFICITI	13,127	18,759	21,885	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-13,127	-18,759	-21,885	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-12,150	-14,220	-21,203	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	44	55	59	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	2,604	-4,986	-1,789	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-14,798	-9,290	-19,473	Others
V.3	I huaj	-977	-4,539	-682	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	420	2,490	3,472	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	114	-2,048	-1,132	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,511	-4,981	-8,184	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	0	0	0	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source : Ministry of Finance and Economy

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

Tabela e investimeve 2022

Table of investments 2022

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar	Shkurt	Mars	
	January	February	March	
Financim i brendshëm	-12,150	-14,220	-21,203	Domestic financing
<i>Në %</i>	92.6	75.8	96.9	<i>In %</i>
Financim i huaj	-977	-4,539	-682	Foreign financing
<i>Në %</i>	7.4	24.2	3.1	<i>In %</i>
Totali	-13,127	-18,759	-21,885	Total
<i>Në %</i>	100	100	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source: Ministry of Finance and Economy

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2022
CUSTOMS AND TAX REVENUES 2022**

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
Taksë doganore	464	1,029	1,728	Customs Duties
TVSH	9,160	20,475	34,070	V.A.T
Akcizë	3,495	7,463	11,367	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	277	603	1,105	Others (Mineral Rent)
TOTALI	13,397	29,570	48,270	Total

TË ARDHURAT TATIMORE 2022 (TAX REVENUE)

TVSH	5,915	9,110	11,569	V.A.T
Tatim mbi fitimin	1,652	3,992	14,277	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	4,028	7,099	10,569	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	5,047	8,111	11,048	National taxes
TOTALI	16,641	28,312	47,462	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	30,037	57,882	95,732	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tab - 7

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2022

*The Deficit and Its Financing for 2022**Të dhëna progresive (Progressive Data)**Në milionë lekë (In million ALL)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
TË ARDHURAT	45,726	87,679	139,408	REVENUE
SHPENZIMET	32,599	68,920	117,523	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	13,127	18,759	21,885	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-13,127	-18,759	-21,885	FINANCING
Financimi i brendshëm	-12,150	-14,220	-21,203	Domestic
Të ardhura nga privatizimi	44	55	59	Privatization receipts
Hua-marrje e brendshme	2,604	-4,986	-1,789	Domestic borrowing
Të tjera	-14,798	-9,290	-19,473	Others
Financimi i jashtëm	-977	-4,539	-682	Foreign
a. Hua afatgjatë	420	2,490	3,472	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	114	-2,048	-8,184	Chang. of stat. Account
c. Ripagesat	-1,511	-4,981	-1,132	Repayments
d. Mbeshtetje Buxhetore			5,161	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë**Source:** Ministry of Finance and Economy

Tab - 8

BILANCI I PAGESAVE*Balance of payments**Në milion Euro**In millions Euro*

	2017	2018	2019	2020	2021	
Llogaria korente	-865.90	-866.40	-1,088.70	-1,152.73	-1,186.26	Current Account.
Bilanci tregtar	-2,824.10	-2,871.10	-3,143.80	-2,982.51	-3,829.34	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	797.10	986.10	906.50	793.63	1,264.79	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,621.20	-3,857.20	-4,050.30	-3,776.14	-5,094.13	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	1,081.90	1,111.00	1,263.90	1,051.72	1,776.10	Services Balance.
Shërbimet Kredi	2,856.20	3,072.80	3,404.60	2,226.22	3,466.03	Services Credit
Shërbimet Debi	1,774.30	1,961.80	2,140.70	1,174.50	1,689.93	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	28.60	-13.80	-180.10	-219.34	-210.98	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	407.40	392.80	420.20	337.10	397.57	Income Credit
Të ardhurat Debi	-378.80	-406.60	-600.30	-556.44	-608.55	Income Debt
Bilanci i transfertave	847.70	907.50	971.30	997.40	1,077.96	Balance of Transfers
Transferta private	961.80	1,005.40	1,105.50	1,169.70	1,244.00	Private Unrequired Transfers
Transferrat shtetërore	-114.10	-97.90	-134.20	-172.30	-166.04	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	122.30	104.00	76.10	143.60	358.46	Capital Account
Llogaria financiare	-1,115.30	-1,142.60	-827.00	-1,504.31	-1,554.51	Financial Account
Investime direkte	-993.80	-1,022.20	-1,036.30	-893.56	-989.93	Direct Investment
Investime portofoli	-100.00	-76.10	140.60	-65.85	-83.95	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	49.00	-50.40	50.90	-403.80	-534.17	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	-186.30	-8.70	107.90	159.33	209.47	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	185.40	371.50	-77.70	654.51	936.18	Overall Balance
Rezervat	185.40	371.50	-77.70	654.70	936.17	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	70.50	-6.10	-17.80	141.10	-53.54	Use of Fund Credit and Loans

*Burimi : Banka e Shqipërisë**Source : Bank of Albania*

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhes	2018	2019	2020	2021	2022 Janar	2022 Shkurt	2022 Mars	Millions of Lek End of Period
					January	February	March	
Mjete valutore neto	724,363	733,114	803,487	937,814	939,296	932,896	923,549	Net foreign assets
Pretendime ndaj jorezidentëve	786,907	794,006	860,750	1,027,069	1,031,821	1,025,224	1,017,093	Claims on nonresidents
Minus Detyrime të jorezidentëve	62,544	60,892	57,263	89,255	92,525	92,328	93,543	Minus: Liabilities to nonresidents
Mjetet e brendshme	874,968	950,426	1,047,835	1,084,106	1,088,115	1,096,426	1,109,457	Domestic assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	340,781	378,524	435,613	412,253	417,768	416,444	420,216	Net claims on central government
Pretendime ndaj sektoreve te tjere	534,187	571,902	612,221	671,852	670,346	679,982	689,241	Claims on other sectors
Detyrimet e parasë së gjërë	1,264,127	1,318,662	1,456,993	1,582,310	1,597,235	1,592,296	1,593,358	Broad Money liabilities
Paraja jashtë Korporatave Depozituese	275,285	291,409	344,560	366,251	362,841	363,289	365,989	Money outside depository corporations
Depozita të transferueshme	375,047	408,780	490,394	584,631	598,282	589,063	590,239	Transferable deposits
Depozita të tjera	613,795	618,473	622,039	631,428	636,112	639,944	637,131	Other deposits
Depozita të përfshira në paranë e gjërë	148,927	178,375	186,892	222,409	215,455	217,705	218,014	Deposits excluded from Broad Money
Qeveria lokale dhe administrata publike								Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	2,092	3,879	4,666	5,877	5,937	5,970	5,923	Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike	376	336	252	392	394	383	388	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	7,399	8,238	6,925	16,599	8,750	9,149	9,855	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	139,061	165,922	175,050	199,541	200,374	202,202	201,848	Other resident sectors
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	6,183	6,656	5,926	7,288	6,910	6,885	7,534	Securities other than shares
Korporata të tjera jofinanciare	164	101	57	67	26	125	208	Korporata të tjera jofinanciare
Sektorë të tjerë rezidentë	6,019	6,555	5,869	7,221	6,884	6,760	7,326	Other resident sectors
Huatë	2,838	2,527	3,757	3,507	3,476	3,073	4,915	Loans
Qeveria lokale dhe administrata publike								Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	2,838	2,527	3,757	3,507	3,476	3,073	4,915	Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike								Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare								Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë								other resident sectors
Llogari të pagueshme	285	229	62	248	336	233	271	Accounts payable
Korporata të tjera Financiare								Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike								Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	1	1	5			7		Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	284	229	57	247	336	226	270	other resident sectors
Aksione dhe instrumenta të tjerë të kapitalit	188,868	200,257	214,394	219,725	220,474	220,484	215,973	Shares and other equity
Nga të cilat rezerva rivlerësimi	-6,266	-2,652	-1,095	-5,442	-5,468	-6,759	-11,270	Of which: Valuation adjustment
Të tjera neto	-12,300	-23,895	-17,621	-14,428	-17,843	-13,038	-10,327	Other items net
Detyrime të tjera	61,547	50,220	55,892	59,094	56,797	60,726	63,196	Other liabilities
Minus: Mjete të tjera	73,847	74,115	73,514	73,521	74,640	73,764	73,523	Minus: Other assets
Axhustimi i konsolidimit	403	729	919.0	862	1,369	1,686	3,268	Consolidation adjustment

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 10 **KREDIA PËR EKONOMINË**
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2018	2019	2020	2021	2022 Janar January	2022 Shkurt February	2022 Mars March	Million of Lek End of Period
Totali i kredisë	532,818.6	570,792.2	608,779.8	666,178.4	664,671.0	674,305.1	683,563.0	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale dhe administratën	682.6	560.6	429.1	313.2	212.9	205.5	200.0	Credits to local Government
Në lekë	682.6	560.6	429.1	313.2	212.9	205.5	200.0	in Lek
Në valutë	-	-	-	-	-	-	-	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	20,270.0	24,182.4	15,150.8	22,521.8	21,254.4	23,276.1	24,510.0	Credits to Public Non-financial Corporations
Në lekë	16,594.1	18,489.7	11,819.6	9,210.6	9,358.1	10,228.9	10,380.0	in Lek
Në valutë	3,675.9	5,692.7	3,331.2	13,311.3	11,896.3	13,047.2	14,130.0	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera jofinanciare	317,578.4	335,884.5	370,356.3	395,162.7	394,103.4	399,605.7	403,166.0	Credits to other Non-financial Corporations
Në lekë	127,739.6	141,240.5	161,975.3	172,000.2	171,500.7	173,010.8	172,641.0	in Lek
Në valutë	189,838.8	194,644.1	208,381.0	223,162.5	222,602.7	226,595.0	230,524.0	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	10,164.0	13,555.1	13,169.1	13,815.7	13,633.5	13,588.0	13,642.0	Credits to Other Financial Corporations
Në lekë	4,802.1	8,023.8	7,489.2	7,772.8	7,326.9	7,151.6	7,271.0	in Lek
Në valutë	5,361.9	5,531.3	5,679.9	6,043.0	6,306.7	6,436.4	6,371.0	in Foreign Currency
Kredia për sektorë të tjerë rezidentë	184,123.6	196,609.5	209,674.5	234,365.0	235,466.9	237,629.8	242,045.0	Credits to other resident sectors
Në lekë	118,934.6	130,409.2	138,986.4	158,093.0	158,725.6	159,793.9	162,267.0	in Lek
Në valutë	65,189.0	66,200.3	70,688.1	76,272.0	76,741.2	77,835.9	79,778.0	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11

OFERTA E PARASË

Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë	2018	2019	2020	2021	2022 Janar January	2022 Shkurt February	2022 Mars March	Millions of LEK End of Period
Fundi i periudhës								
Baza monetare	423,428	433,951	534,347	565,163	557,155	566,146	561,563	Monetary base
Paraja jashtë korporatave depozituese	275,285	291,409	344,560	366,251	362,841	363,289	365,989	Currency outside depository corporations
Agregati M1	478,721	523,968	637,317	701,404	699,228	695,465	694,568	M1 Aggregate
Agregati M2	731,502	758,022	862,338	918,474	915,120	910,349	907,331	M2 Aggregate

Burimi : Banka e Shqipërisë**Source** : Bank of Albania

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2018	2019	2020	2021	2022 Janar January	2022 Shkurt February	2022 Mars March	Millions of Leks End of Period
Totali i depozitave	988,842	1,027,253	1,112,433	1,216,059	1,234,394	1,229,007	1,227,370	Total of deposits
Në lekë	456,217	466,613	517,778	552,223	552,279	547,060	541,342	In national currency
Depozitat e transferueshme	169,425	190,538	241,316	276,074	275,246	270,240	267,355	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	1,482	1,624	1,644	1,302	1,430	1,361	1,333	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	8,662	10,667	13,747	17,118	13,343	13,639	13,987	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	2,570	3,694	3,666	4,744	4,683	4,248	4,968	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	47,156	49,099	66,074	77,758	80,228	73,780	71,284	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	109,555	125,454	156,185	175,154	175,560	177,211	175,783	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	34,012	42,021	51,442	59,079	61,142	61,936	61,225	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike								Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	199	120	166	1,762	2,772	2,767	2,802	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	16	87	131	78	78	78	78	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	2,066	2,873	3,970	3,554	3,990	3,756	3,228	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	31,730	38,942	47,175	53,686	54,302	55,335	55,117	Other resident sectors
Depozita të tjera	252,781	234,053	225,021	217,070	215,892	214,884	212,762	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	13	10	10					Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,635	709	1,465	757	603	603	603	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	5,051	4,147	4,868	5,136	4,168	4,075	4,363	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	9,687	7,978	6,836	7,598	7,342	7,229	6,390	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	236,395	221,210	211,841	203,579	203,779	202,978	201,407	Other resident sectors
Në valutë	532,625	560,640	594,655	663,836	682,115	681,947	686,028	In foreign currency
Depozitat e transferueshme	205,623	218,241	249,078	308,556	323,036	318,823	322,884	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	113	158	82	39	70	60	37	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,355	2,688	2,246	2,465	3,309	4,303	4,105	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	3,616	5,360	6,742	6,143	6,699	5,948	6,290	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	75,861	79,001	90,281	116,544	124,501	119,581	123,237	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	124,676	131,036	149,726	183,366	188,457	188,932	189,214	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	83,610	106,417	120,699	136,407	137,737	139,212	137,852	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike								Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	53	136	97	94	87	148	191	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	0	1	1	10	0	11	10	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	2,194	2,786	5,845	3,739	3,857	3,728	3,383	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	81,363	103,495	114,755	132,565	133,792	135,326	134,267	Other resident sectors
Depozita të tjera	243,393	235,982	224,878	218,873	221,342	223,912	225,292	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike				24	0	0	26	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,696	1,522	1,732	1,519	2,341	2,349	2,493	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	3,598	7,058	6,939	8,936	8,092	8,689	7,923	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	11,814	11,662	10,854	12,622	13,941	14,063	16,105	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	226,284	215,741	205,353	195,771	196,969	198,811	198,745	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 33 Tregues të shëndetit financiar (FSI)
(në përqindje)

Financial Soundness Indicators (FSI)
(in percentage)

Përshkrimi / Description	Mar 21	Prill 21	Maj 21	Qer 21	Korr 21	Gush 21	Shtet 21	Tet 21	Nën 21	Dije 21	Jan 22	Shk 22	Mar 22	Index Description
Tregues me bazë kapitalit														
Kapitali regulator ndaj aktiveve të pondëruara me rrezik (në %)	18.00	0.00		18.00	0.00	0.00	18.00			18.00	0.00	0	18	Regulatory capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali regulator (miln lekë)	155,923			158,486			164,622			167,215			170076	Regulatory capital (million lek)
Aktive të pondëruara me rrezik (miln lekë)	861,258			883,172			899,548			928,994			948,127	Risk-weighted assets
Kapitali regulator i nivelit I ndaj aktiveve të pondëruara me rrezik (në %)	17.00	0.00		17.00	0.00	0.00	17.00			17.00	0.00	0	17	Regulatory Tier 1 capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Tregues me bazë aktiveve														
Kapitali regulator i nivelit I ndaj totalit të aktiveve	9.00	9.00	9.00	9.00	9.00	9.00	9.00	9.00	9.00	9.00	9.00	9.00	9.00	Capital as a percent of total assets
Kapitali regulator ndaj totalit të aktiveve (në %)	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00	9.00	9.00	10.00	10.00	Regulatory Tier 1 capital as a percent of total assets
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve (në %)	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00	10	10	Shareholders' equity as a percent of total assets (in %)
Huatë me probleme neto nga provizionet ndaj kapitalit (në %)	11.00	11.00	11.00	10.00	9.00	9.00	8.00	9.00	8.00	8.00	8.00	8.00	7.00	Nonperforming loans net of provisions as a percent of capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provizionet ndaj kapitalit regulator të nivelit I (në %)	10.00	10.00	10.00	9.00	9.00	9.00	8.00	8.00	8.00	7.00	7.00	7.00	7.00	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provizionet ndaj kapitalit aksioner (në %)	9.00	10.00	10.00	9.00	8.00	8.00	8.00	8.00	8.00	7.00	7.00	7.00	7.00	Nonperforming loans net of provisions as a percent of shareholders' equity (in %)
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore) (në %)	12.00	12.00	12.00	13.00	12.00	12.00	13.00	13.00	13.00	13.00	6.00	8	7	Return on equity (ROE) (annual basis) (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit (në %)														Net open position in foreign exchange as a percent of capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit regulator të nivelit I (në %)	8.00	4.00	5.00	5.00	7.00	8.00	8.00	8.00	9.00	10.00	7.00	7.00	11.00	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner (në %)	8.00	4.00	5.00	5.00	7.00	7.00	8.00	8.00	9.00	9.00	6.00	7.00	10.00	Net open position in foreign exchange as a percent of shareholders' capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner (në %)	7.00	4.00	4.00	4.00	7.00	7.00	7.00	7.00	8.00	9.00	6.00	6	9	Net open position in foreign exchange as a percent of shareholders' capital (in %)
Tregues me bazë aktiveve														
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda e gjërë)	34.00	33.00	34.00	34.00	34.00	34.00	33.00	33.00	32.00	33.00	34.00	30.00	28.00	Liquid assets as a percent of total assets (broad measure)
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda bazë)	12.00	11.00	12.00	13.00	13.00	14.00	13.00	13.00	12.00	13.00	13.00	14.00	13.00	Liquid assets as a percent of total assets (core measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda e gjërë)	46.00	45.00	46.00	47.00	47.00	46.00	46.00	45.00	45.00	45.00	47.00	41.00	38.00	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (broad measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda bazë)	16.00	15.00	17.00	17.00	17.00	19.00	18.00	17.00	17.00	18.00	18.00	19.00	18.00	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (core measure)
Kthimi nga aktiveve (ROA) (bazë vjetore) (titimi neto para taksave)	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	Return on assets (ROA) (annual basis) (net profit before taxes)
Huatë me probleme (bruto) ndaj totalit të huave (në %)	8.00	8.00	8.00	7.00	7.00	7.00	6.00	6.00	6.00	6.00	5.00	5	5	Nonperforming loans (gross) as a percent of total loans (in %)
Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve														
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	76.00	75.00	75.00	74.00	75.00	74.00	74.00	74.00	75.00	74.00	90.00	84.00	88.00	Interest margin to gross income
Shpenzime jointerese ndaj të ardhurave bruto	59.00	58.00	59.00	57.00	58.00	58.00	58.00	58.00	59.00	60.00	66.00	61	66	Noninterest expenses to gross income
Të tjera														
Numri i bankave	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00	Number of banks
Burimi - Banka e Shqipërisë														
Source - Bank of Albania														